

DPK/DMP

03-352/2013

03

12-02-2013

Nr. 492-05/12

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE, me

gjkatesen Vjollca Buzhala e me procesmbajtesen Melihate Shaipi ne proceduren kundervajttese kunder te pandehures Ajete Nezaj nga fsh. Romaje KK Prizren , per shkak te kundervajtjes nga neni 5 , 6, par.1 .3 dhe nenin 9 te Ligjit nr. 04/ L- 050, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte publik , dhe deklarimin , prejardhjen , dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar sakncionuar ne baze te nenit 17 par. 1 . 3 te Ligjit te lart cekur , e ne kuptim te nenit 195 te LMK-se me dt. 25.01.2013 mori kete

A K T V E N D I M

E pandehura Ajete Nezaj nga I ati Haki e lindur me 1982 ne fsh. Romaje KK Prizren ku edhe jeton , me kombesi shqiptare, e pa martuar , ka te kryer fakultetin e psikologjise , e gjendjes se mesme ekonomike.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S E

Sepse e pandehura ne cilsi te asamblisites komunale , ne Kuvendin Komunal ne Prizren, nuk ka bere deklarimin e pasurise ne afatin e regullte ligjor deri me dt. 31.03.2012 , deklarim I cili I obligon te gjithë zyrtaret e larte publik që pasurinë e tyre ta deklarojen regullisht për qdo vit ,sipas kerkeses se AKK – nuk ka permbushur këtë obligimin ligjor mbrenda afatit .

-me te cilin veprim ka kryer kundervajtjen nga neni 5 , 6, par.1 .3 dhe nenin 9 te Ligjit nr. 04/ L- 050, per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të zyrtareve te larte publik , dhe deklarimin , prejardhjen , dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtar sakncionuar ne baze te nenit 17 par. 1 . 3 te Ligjit te lart cekur , e per kete

D E N O H E T

Me gjobe prej 250 euro / dyqindeepesedhjeteeuro /,

I pandehuri obligohet qe gjoben e shqiptuar te paguan ne afat prej 15 dite, nga dita e plotfusqishmerise se ketij aktvendimi ne te kunderten do te zevendesohet me denim burgimi duke llogaritur 15 euro me nje dite , poashtu I pandehuri obligohet qe ne afat te lartecekur te paguan 5 euro ne emer te paushallit gjyqesor, nen kercnim te egzekutimit te dhunshem.

A r s y e t I m

Sipas kerkeses se Agjensionit antikorupcion ne Prishtine, me nr. 01- 1907/2012 te dt. 24.05.2012 eshte ngritur procedura kundervajttese kunder te pandehures Ajete Nezaj nga fsh. Romaje , asambleiste

Gjyqtari filloi proceduren kundervjatese ne Gjykate ne seancen verbale te dt. 05.07.2012 ku e cila pos tjerash theksoi :

Eshte e vertet se me date 24.05.2012. eshte ngritur procedura kundervjatese ndaj meje si zyrtar publike ne cilesine e asambleistit Komonale ne Prizren per shkak te mosdeklarimit te pasurise . Une kete formulare e kam dorzuar ne agjensionin antikorupcion me date 11.07.2012 sepse nuk kame ditur se dorzimi I ketij formulari eshte I lidhur me ndonje afat kohor . Arsyja tjeter eshte se nuk kame kurfar pasurije , dhe qdo gje qe e kame bere kame bere per shkak e mosdijes , nuk kame dashtur qe ti iki pergjegjesis por e vetmja arsye eshte se nuk kame dite se nje gje e tille do te kete pasoja .

Andaj Gjykata me qellim te vertetimit te drejte te gjendjes faktike ne cilesi te deshmitarit mori ne pyetje zyrtarin e larte - te mbikqyrjes se pasurise ne AKK Enis Sadiku I cili pos tjerash theksoj: Eshte e vertete se Agjensioni antikorupcion permes pikave konstaktuese ka njoftuar zyrtaret e larte per obligimin e deklarimit te gjendjes se pasurise dhe nje nder ata persona eshte edhe zyrtarja Ajete Nezaj nga fsh. Romaje - asambleiste ne Asamblen Komonale ne Prizren . Agjensioni antikorupcion ka bere nifotimin per kete zyrtar se afati I fundit ligjro per deklarimin e pasurise eshte data 31.03.2012 dhe qe nga data e marjes se njoftimit dhe me dt. e parashtrimit te kerkeses personi ne fjale nje gje te tille nuk e ka bere ,kjo mund te konstatohet se zyrtarja e larte ka qene I njoftuar ne baze te listes distribuese qe eshte shperndare me dt. 01.03.2012 e te cilen e ka pranuar edhe e njejta.

Gjithashtu gjykata per ta vertetuar gjendjen faktike ftoi ne cilsu te deshmitarit Samir Hoxhen - ish shef I protokolit ne kabinetin e kryetarit te komunes ne Prizren si pike kontaktuese I cili ne deklaraten e tij te thene ne gjykate me date 8.11.2012. theksoi : une personalishte lidhur per formularin per deklarimin , preardhjen dhe kontgrollin e pasurise e kame njoftuar personin kompetent zortin Ibrahim Gashi e besoi qe I njejtj I ka njoftuar me kohe .

Deshmitari Ibrahim Krasniqi si shefi I sherbimit profesional ne deklaraten e dhene ne gjykate me date 12.12.2012. theksoi : une ne cilsine e kordinatorit per sherbime profesionale deklaroi se asne formulare nuk kame pranuar personalishte nga zorti Samir Hoxha si pike kont aktuese sepse na ka njoftuar vetem gojarishte keshteu qe une iu kame shperndare antareve te Kuvendit formularet te cilet une I kame poseduar por asnje formular zonjusha Ajete Nezaj te plotsuar nuk ma ka kthyer ne afatin e rregullt ligjor .

Gjendja faktike e pershekruar me persëafermi si ne dispozitiv të ketij aktvendimi është vertetuar permes deklarates se te pandehurit , deklarates se zyrtarit te larte per antikorupsion , pikes kontaktuese - zyrtarit Samir Hoxha , deshmitarit Ibrahim Krasniqi - shef I sherbimit profesional , listes distributive te dt. 01.03.2012. si dhe me administrimin e provave tjera ne shkresat e lendes .


Deklaraten mbrotjese te te pandehures se kam menduar se nje gje e tille nuk ka rendesi edhe nese nuk e dorzoi me kohe pasi nuk kame kurfar pasurije per ta deklarar Gjykata e ka vleresuar por te njejtën e ka hudhur poshte si të pabazuar , nga se e njejta ka per qellim ti ik pergjegjeise juridiko kundervjatese , besimin ia fali zyrtarit te larte antikorupsion Enis Sadiku , deshmitarit Ibrahim Krasniqi , deshmitarit Samir Hoxha , te pandehuren e shpalli pergjegjese dhe e denoi me gjobe me bindje se edhe me kete lloj denimi do të arihet qellimi I duhur ndëshkimor , qe në të ardhmen mos të kryej kundervajtje të tilla apo të ngjashme.

Gjate caktimit te denimit jane vleresuar rrethanat nen te cilat eshte kryer kundervajtja, pesha e kundervajtjes te kryer dhe pasojat e saja shkalla e pergjegjesise, rrethanat materijale te pandehures , e si rrethane lehtesuese ne kuptim te nenit 7 te LMK_se eshte mare ajo se e pandehura per here te pare eshte

paraqitur ne gjykate per kesolloj te kundervajtjes, per shkak te mosdijes nuk ka bere nje deklarim te tille duke menduar se nuk ka kurfar pasurije per ta deklaruar, andaj dhe ne vend te denimit me burg ia shqiptoi denimin me gjobe me bindje se edhe me nje denim te tille do te arihet qellimi I deminit qe ne te ardhmen nuk do te kryeje vepra te tilla apo te ngjajshme

Lartesia e shpenzimeve te procedures eshte caktuar ne baze te nenit 109 te LMK.
Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitive te aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE
Nr. 492 -05 /2012
te dt. 26.1.2013



Procesmbajtesja
Melihate Shaipi

III Gjykatësi per kundervajtje
Vjollca Buzhala

UDHEZIMI JURIDIK : Kunder ketij aktvendimi e ne afat prej 8 ditesh nga dorezimi mund te ushtrohet ankese Gjykates se Apelit ne Prishtine Divizioni per Kundervajtje, permes kesaj gjykate pa taksa.